

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT**  
**DREJTORIA ARSIMORE RAJONALE**  
**QËNDRA KULTURORE E FËMIJËVE**

Nr.prot \_\_\_\_\_

Shkodër, më \_\_.01.2014

**Lënda: Dërgohet platforma e konkursit “Bilbilat e vegjël”**

*Drejtorisë së shkollës “ \_\_\_\_\_ ”*

*“Bilbilat e vegjël të Shkodrës këndojnë”*  
(Edicioni i 19 -të)

Duke filluar nga data **19.02.2014** DAR dhe Q. K. e Fëmijëve Shkodër organizojnë konkursin e këngëtarëve të vegjël të shkollave 9 vjeçare **“BILBILAT E VEGJËL TË SHKODRËS KËNDOJNË”**, edicioni i nëntëmbëdhjetë. Ndryshe nga edicionet e mëparshme, këtë vit kjo veprimtari zhvillohet në katër faza dhe në të do të marrin pjesë këngëtarë të dalluar nga të gjitha shkollat e qarkut Shkodër.

Faza e parë

Zhvillohet në shkolla.

Pas një seleksionimi në bazë klase që bën mësuesi i muzikës së bashku me mësuesin kujdestar, zgjidhen më të mirët të cilët konkurojnë në mes tyre në bazë shkolle. Këngëtarët përgatiten dhe konkurojnë me një strofë dhe një refren të një kënge që këndohet pa shoqërim (a capela). Vlerësimi në këtë fazë bëhet nga një Juri me mësues të shkollës, të cilët selekcionojnë dhe përcaktojnë më të mirët të cilët përfaqësojnë shkollën në fazën e dytë.

Faza e dytë

Zhvillohet në zona dhe në të marrin pjesë më të mirët e çdo shkolle pa kufizim në numër. Këngëtarët në këtë fazë përgatiten që të konkurojnë me dy këngë që këndohen pa shoqërim (a capela). Programi i konkurimit me: **emrin e këngëtarit klasën dhe titujt e këngëve** i paraqitet Jurisë në 5 kopje. Vlerësimi në këtë fazë bëhet nga juria e specialistëve të Q. K. të Fëmijëve.

Konkurimi në këtë fazë zhvillohet sipas kalendarit të mëposhtëm.

Vlerësimi në këtë fazë bëhet nga një Juri me mësuesit e muzikes dhe specialist të QKF. të cilët seleksionojnë dhe përcaktojnë më të mirët të cilët përfaqësojnë zonën në fazën e tretë.

Konkurimi në këtë fazë zhvillohet sipas kalendarit të mëposhtëm:

Data	Zona	Shkolla
19.02.2014 <b>ora 10.00</b>	RRETHINA Konkurimi ne Golem	Grude e re - Guci e re - Golem Shtoj i vjeter - Shtoj i ri - Hot i ri Dobraç - Bardhej
20.02.2014 <b>ora 10.00</b>	ANA E MALIT Konkurimi ne Obot	Oblik - Obot - Zues - Elbace Muriqan - Obot i vjeter
21.02.2014 <b>ora 10.00</b>	BERDICE Konkurimi ne Berdice	Berdice - Berdic e siperme Beltoje - Trush
24.02.2014 <b>ora 10.00</b>	VAUDEJES Konkurimi ne Vau Dejs	Vaudejes - Mjede - Shelqet Kaçe - Naraç - Karme - Dush - Jakaj
25.02.2014 <b>ora 10.00</b>	VELIPOJE Konkurimi ne Velipoj qender	Velipoje - Velipoje e re
26.02.2014 <b>ora 10.00</b>	HAJMEL Konkurimi ne Hajmel	Hajmel - Nenshat - Mnele e vogel Pistull - Vig - Mnele e madhe
27.02.2014 <b>ora 10.00</b>	POSTRIBE SHALE – PULT - SHOSH  Konkurimi ne Mes	Mes Myselim - Domen Dragoç - Drisht, Vilze - Ura e shtrenjte Prekal - Breg lumi - Gimaj Bruçaj - Kir - Plan - Xhan Ndrea Shosh – Palaj Shosh
28.02.2014 <b>ora 10.00</b>	GUR I ZI Konkurimi ne Gur i Zi	Gur i zi - Rrenc - Vukatane - Rragam Juban - Kuç - Sheldi - Mazrek
03.03.2014 <b>ora 10.00</b>	BUSHAT Konkurimi ne Bushat	Bushat - Barbullush - Ashte - Rranxa Kosmaç - Melgushe - Fshat i ri - Stajka
05.03.2014 <b>ora 10.00</b>	DAJÇ Konkurimi ne Dajç	Dajç - Shirq - Mushan Pentar - Samrish i ri
06.03.2014 <b>ora 10.00</b>	SHLLAK-TEMAL Konkurimi ne Koman	Kisharre - Vile - Shllak - Kodernikaj Koman - Toplane - Barcolle

### Faza e tretë

Zhvillohet në sallën e Q.K. të Fëmijëve data e së cilës përcaktohet pas fazës dytë. Në këtë fazë këngëtarët konkurojnë me nje kenge të shoqëruar me baze muzikore (orkestrale). Për këtë konkurentët përgatiten me mesuesit e muzikes dhe specialistë të QKF. Emrat e pjesmarresve, data dhe ora e konkurimit per kete faze njoftohen ne fund te fazes se dyte.

**Juria në fund të fazës së trete përcakton finalistët të cilët në vazhdim nisin përgatitjet për finalen e madhe.**

### *Faza finale*

Finalja zhvillohet ne muajin prill 2014. Në këtë fazë marrin pjesë këngëtarët më të mirë të shpallur nga juria në fund të fazës së tretë. Materiali muzikorë për të gjithë finalistët përcaktohet nga organizatorët në përshtatje me moshën, karakteristikat vokale si dhe duke patur në konsideratë materialin e paraqitur në tri fazat seleksionuese.

Për vlerësimin e këngëtarëve do të ngrihen dy juri, të cilat do të vlerësojnë të ndara njëra nga tjetra. Njëra do përbëhet nga specialistët më mirë të kësaj fushe (që ka qyteti ynë e më gjërë) dhe tjetra me mësues muzike.

Finalja do të ketë formën e spektaklit ku do të ketë edhe të ftuar nderi. Në bazë të pikëve të grumbulluara do të shpallen këngëtarët më të mirë dhe në bazë të pikëve të grumbulluara nga çdo këngëtar do të bëhet klasifikimi i shkollave.

Për Q. K. TË FËMIJËVE

Për D. A. R. SHKODËR

**Drejtori**

***Dirigjent:* KujtimALIA**

**Drejtores**

**Erjeta SINANI(LAÇEJ)**

**Shënim: Për çdo paqartësi apo sqarim, drejtohuni në Q.K. të Fëmijëve çdo ditë nga ora 9.00 - 12.00 dhe 15.00 - 19.00.**

***ose me telefon:*       0692047925  
                                  0674060462**